



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJ
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**

Informacion mbi aktivitetin e planifikuar në projektin:
“Interpretimi/përkthimi në realitetin virtual. Integrimi i teknologjisë në procesin e përkthimit”

***-Trajnimi dhe aftësimi i studentëve në fushën e përkthimit virtual-
organizuar nga Dr. ERTA SPAHO, datë 08.06.2023***

Në vijim të aktiviteteve të organizuara në kuadër të projektit *Interpretimi/përkthimi në realitetin virtual. Integrimi i teknologjisë në procesin e përkthimit. -Trajnimi dhe aftësimi i studentëve në fushën e përkthimit virtual-* si dhe mbështetur në analizën e pyetësorëve të organizuara nga grupi i punës së këtij projekti, më datë 08.06.2023 u organizua me studentët e programit të studimit *Master në përkthim-interpretim dhe Bachelor në përkthim-interpretim* trajnimi me temën *“Përkthimi automatik në fushën juridike”*.

Trajnimi u realizua nga Dr. Erta Spaho, e cila e ka fokus të punës së saj shkencore fushën e përkthimit juridik. Trajnimi ishte me shumë interes për studentët dhe gjatë trajnimit pati diskutime interesante.

Trajnimi u fokusua në këto çështje:

1. Përkthimi njerëzor përballë përkthimit automatik: Përparësitë dhe problemet
2. Kombinimi i përkthimit automatik me përkthimin njerëzor
3. Përkthimi automatik me editim të mëposhëm: Post-editing, pra: lexim, korigjim, redaktim
4. Tekstet paralele





